

LIGJ
Nr.7661, datë 19.1.1993

PËR KONTABILITETIN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky ligj përcakton detyrimet e përgjithshme dhe parimet e rregullat kryesore për mbajtjen e kontabilitetit dhe përgatitjen e publikimit të informacionit financiar që mbështetet në të dhënat e kontabilitetit.

Neni 2

Ky ligj vepron mbi të gjitha subjektet pjesëmarrëse në ekonomi, persona juridikë e fizikë, që janë regjistruar në Republikën e Shqipërisë, qofshin këta me objekt tregtar a formë tregtare (në vijim do të quhen "ndërmarrje"), qofshin subjekte jotregtare, por që shtrajnë veprimtari ekonomike. Ai vepron gjithashtu mbi institucionet dhe entet shtetërore, qendrore e lokale, që përfaqësojnë njësi të pavarura buxhetore ose me natyrë

buxhetore, si dhe mbi njësitë e krijuara prej tyre.

Për mbajtjen e kontabilitetit dhe publikimin e informacionit që nxirret prej tij, të gjitha subjektet, mbi të cilat vepron ky ligj zbatojnë sistemet ose regjimet kontabël të miratuara nga Këshilli i Ministrave dhe nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, siç parashikohet në nenet 3 dhe 4 të këtij ligji.

Neni 3

Këshilli i Ministrave miraton:

a) Sistemin kontabël të përgjithshëm, i cili, me përshtatjet e parashikuara nga ky ligj, zbatohet nga të gjitha subjektet që do të mbajnë kontabilitetin e tyre sipas parimit të të drejtave të konstatuara.

b) Sistemet kontabël të veçantë që rezultojnë nga nevoja e përshtatjeve të sistemit kontabël të përgjithshëm me veçoritë e veprimtarisë së subjekteve që vijnë;

- të bankave dhe institucioneve financiare, si dhe të subjekteve të tjera që kanë për objekt kryesor ushtrimin e veprimtarive financiare;

- të institucioneve dhe të organizatave buxhetore, qendrore e lokale, si dhe të njësive të krijuara prej tyre.

Neni 4

Ministria e Financave dhe e Ekonomisë miraton:

a) Sistemet kontabël të veçantë që rezultojnë nga nevoja e përshtatjeve të sistemit kontabël të përgjithshëm me veçoritë e veprimtarisë së subjekteve që i nënshtrohen këtij të fundit, me përjashtim të atyre të parashikuara në shkronjën "b" të nenit 3 të këtij ligji.

b) Regjimet kontabël për subjektet, të cilat, sipas paragrafëve të dytë e të tretë të nenit 10 të këtij ligji, do të mbajnë kontabilitetin e tyre sipas parimit të arkëtimeve dhe të pagesave ose do të

mbajnë një kontabilitet të thjeshtuar.

Neni 5

Sistemet dhe regjimet kontabël, të parashikuara në nenet 3 dhe 4 të këtij ligji, përgatiten në formën e planeve ose të udhëzimeve kontabël dhe kanë karakter të detyrueshëm. Miratimi i tyre nga Këshilli i Ministrave ose nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë mbështetet nga një mendim me shkrim i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, funksionet e të cilit janë përcaktuar në nenet 73 dhe 74 të këtij ligji.

Sistemet dhe regjimet kontabël, të parashikuara në nenet 3 dhe 4, nuk mund të përcaktojnë detyrime të tjera nga ato të parshikuara në këtë ligj, përveç rastit kur detyrimet shtesë rrjedhin nga ligje të tjera.

KREU II DETYRIMET KONTABEL TË PËRGJITHSHME

MBAJTJA E KONTABILITETIT

Neni 6

Mbajtja e kontabilitetit është në funksion, nëpërmjet të cilit çdo subjekt regjistron, sipas rregullave, metodave dhe teknikave kontabël, veprimet që kryen dhe ngjarjet që i ndodhin gjatë ushtrimit të veprimtarisë, të cilat sjellin ndryshime në pasurinë ose në gjendjen financiare të tij.

Kontabiliteti mbahet në gjuhën shqipe dhe në lekë shqiptarë.

Lejohet që për veprime të kryera në monedha të huaja dhe gjendjet e shprehura në këto monedha të mbahen llogari të veçanta, duke kryer konvertimin e tyre në lekë shqiptarë të paktën një herë në muaj, si dhe në mbyllje të çdo ushtrimi.

Me përjashtim të rasteve kur nuk është e ndaluar nga dispozita të tjera, çdo subjekt mund t'ua besojë mbajtjen e kontabilitetit të tretëve, personave juridikë dhe fizikë, të pajisur me dëshmi të posaçme nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë.

Neni 7

Për mbajtjen e kontabilitetit përdoren libri ditar, libri i madh, libri inventar dhe çdo libër tjetër i detyrueshëm, parashikuar nga kodi tregtar ose nga dispozita të tjera ligjore.

Çdo subjekt mund të përdorë, përveç librave të detyrueshëm, edhe libra të tjerë për regjistrimin e veprimeve, të ngjarjeve dhe të gjendjeve, sipas nevojave të tij.

Çeljet dhe regjistrimet në librat e kontabilitetit përshkruhen në gjuhën e përdorimit të zakonshëm. Kur përdoren shkurtime, numra, kode ose simbole, kuptimi i tyre përcaktohet qartë në çdo rast të veçantë.

Çeljet dhe regjistrimet në librat e kontabilitetit duhet të jenë të plota, të sakta dhe të kryhen në kohë e në mënyrë të rregullt. Ato duhet të jenë të kuptueshme nga origjina e veprimit e deri në fund.

Në raste korrigjimesh regjistrimet në librat e kontabilitetit duhet të mos ndryshohen në mënyrë të tillë që të humbë kuptimin fillestar ose të bëhet e paqartë nëse veprimet ishin në fillim apo janë kryer në një datë të mëvonshme.

Në kushtet e mbajtjes të një kontabiliteti të informatizuar, libri ditar, libri i madh dhe libra të tjerë mund të zëvendësohen me dokumente informatike. Në këtë rast duhet të sigurohet shtypja e të dhënave për t'u parë në mënyrë vizuale dhe kushtet e tjera që garantojnë mbajtjen e rregullt të kontabilitetit.

Neni 8

Në librin ditar regjistrimet kryhen në mënyrë kronologjike dhe veprim për veprim. Nuk lejohet që veprime të kryera në data të ndryshme të rimerren me një regjistrim, qofshin këto edhe të një natyre.

Në librin ditar duhet të tregohet, për çdo regjistrim kontabël, origjina, përmbajtja dhe përfshirja e çdo të dhëne, si dhe referencat e dokumentit justifikues që mbështet regjistrimin.

Libri ditar mund të jetë i detajuar në ditarë ndihmës. Në këtë rast regjistrimi kronologjik i veprimeve, siç parashikohet në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, kryhet në ditarët ndihmës.

Këto regjistrime përmbledhen në librin ditar një herë në muaj.

Shumat e regjistruara në librin ditar mbahen çdo muaj në librin e madh dhe në librat ndihmës të tij.

Neni 9

Çdo regjistrim kontabël, me përjashtim të rasteve që përcaktohen nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, mbështetet në një dokument justifikues (fillestar).

Çdo dokument justifikues përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen që ka për objekt. Ai duhet të përmbajë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore e vlerorë, personat që kanë autorizuar dhe ekzekutuar veprimin, si dhe të dhëna të tjera të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative.

Veprimet e së njëjtës natyrë, të kryera në të njëjtin vend dhe gjatë së njëjtës ditë, përmbledhen në një dokument të vetëm justifikues dhe të përfshihen në të njëjtin regjistrim në ditar.

Kërkesat e formës dhe të vlefshmërisë të dokumenteve justifikuese për t'u pranuar për regjistrime në kontabilitet përcaktohen në rregjimet kontabël.

Neni 10

Subjektet e parashikuara në shkronjën "b" të nenit 3, subjektet me kapital të ndarë në aksione ose pjesë dhe subjektet e tjera, mbi të cilat vepron ky ligj, përveç atyre të parashikuara në paragrafët e dytë e të tretë të këtij neni, do të mbajnë kontabilitetin e tyre sipas parimit të të drejtave të konstatuara.

Subjektet me kapital të pandarë në aksione a në pjesë, që nuk i kapërcejnë treguesit e caktuar më poshtë, mund të mbajnë kontabilitetin e tyre sipas parimit të arkëtimit dhe të pagesave:

- shuma e të ardhurave vjetore nga veprimtaria deri në 50 milionë lekë për shitjet e sendeve dhe 15 milionë lekë për shërbime.

- numri mesatar vjetor i punëtorëve të përhershëm të punësuar deri në 10 vetë.

Kjo e drejtë humbet nëse gjatë dy ushtrimeve të njëpasnjëshme tejkalohet njëri prej dy treguesve të vendosur.

Tregtari individual që vendos llogaritë me autoritet tatimor mbi bazën e të ardhurave (jo të rezultatit), mund të mbajë një kontabilitet të thjeshtuar.

Neni 11

Forma e organizimit të kontabilitetit zgjidhet nga vetë subjekti; për çdo formë duhet të sigurojë:

- Regjistrimin e hollësishëm dhe kronologjik të të gjitha veprimeve dhe të ngjarjeve që trajtohen në kontabilitet.

- Ruajtjen e të dhënave dhe disponimin e tyre në çdo kohë.

- Përgatitjen e dokumenteve përmbledhëse të parashikuara ose të kërkuara.

Kontrollin e saktësisë së të dhënave të trajtuara.

Çdo subjekt përgatit dhe ruan një dokument që përshkruan organizmin dhe procedurat kontabël, kur ky dokument është i nevojshëm për kuptimin e sistemit të trajtimit të informacionit kontabël dhe të kryerjes së kontrollit.

Çdo formë e organizimit të kontabilitetit duhet të mundësojë kryerjen e kontrollit të jashtëm në mënyrë të tillë, që, një ekspert të nxjerrë nga librat kontabël, brenda një kohe të arsyeshme, një pamje të përgjithshme të veprimeve të kryera dhe të gjendjes së subjektit.

INVENTARI

Neni 12

Në kohën e krijimit çdo subjekt përgatit një inventar të elementëve të aktivitetit dhe të pasivitetit të pasurisë së tij.

Inventari përgatitet gjithashtu në mbyllje të çdo ushtrimit kontabël në funksion të përgatitjes së llogarive vjetore, si dhe në raste të tjera të panevojshme.

Në kuptim të këtij ligji me inventar kuptohet verifikimi i hollësishëm fizik e dokumentar (kontabël) i elementëve të pasurisë, regjistrimi i tyre në dokumente të posaçme edhe në librin e inventarit, si dhe vlerësimi i elementëve të aktivitetit e të pasivitetit për t'u dhënë këtyre elementëve vlerat aktuale në datën e kryerjes së inventarit.

Vlerësimi i elementeve të pasurisë në datën e inventarit kryhet sipas rregullave të parashikuara në kreun IV të këtij ligji.

Neni 13

Inventari fizik i sendeve të luajtshme kryhet të paktën një herë në 12 muaj dhe si rregull, në një datë të afërt me datën e mbylljes të ushtrimit kontabël.

Inventari fizik i sendeve të paluajtshme kryhet të paktën një herë në çdo 3 vjet, por efektet e zhvlerësimit të tyre nga përdorimi ose nga shkaqe të tjera vlerësohen e merren në llogari për çdo ushtrim kontabël.

Inventari kontabël kryhet të paktën një herë në çdo 12 muaj dhe, si rregull, në kohën e mbylljes së llogarive vjetore.

Diferenca e zbuluar me anë të inventarit dhe çdo sistemim tjetër i të dhënave të kontabilitetit që rezulton prej tij, regjistrohen për llogari të ushtrimit kontabël, për të cilin është kryer inventari.

DOKUMENTET FINANCIARE PËRMBLEDHËSE

Neni 14

Në mbyllje të çdo ushtrimit kontabël ndërmarrjet dhe subjektet e tjera që i nënshtrohen këtij ligji, përgatitin llogaritë vjetore, duke u mbështetur në regjistrimet e kontabilitetit dhe në të dhënat e inventarit.

Me rezervën e ndryshimeve dhe të përshtatjeve të autorizuar nga ky ligj, llogaritë vjetore përmbajnë bilancin, llogarinë e fitimeve dhe të humbjeve, si dhe një aneks, që formojnë një të tërë të pandarë.

Llogaritë vjetore mbulojnë një periudhë prej 12 muaj, duke përjashtuar ushtrimin e parë kur subjekti krijohet gjatë vitit.

Ushtrimi kontabël përputhet, si rregull, me vitin kalendarik. Përjashtimet për veprimtari të veçanta autorizohen nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë.

Neni 15

Ndërmarrjet dhe shoqëritë, të cilat sipas dispozitave të nenit 219 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" gjenden në pozitën e një ndërmarrjeje kontrolluese, përgatitin, përveç llogarive vjetore të vetat, edhe llogaritë vjetore të grupit (llogaritë e konsoliduara).

Kushtet dhe rregullat e përgatitjes dhe të paraqitjes së llogarive vjetore të konsoliduara përcaktohen me ligj të veçantë.

Neni 16

Llogaritë vjetore të japin një pamje besnike të pasurisë, të gjendjes financiare dhe të rezultateve të veprimtarisë së ndërmarrjes.

Llogaritë vjetore, individuale dhe të konsoliduara përgatiten në tekste të shkruara në gjuhën shqipe dhe me shifra të shprehura në lekë shqiptarë, Llogaritë vjetore përmbajnë emrin e ndërmarrjes, qendrën shoqërore (selinë), formën juridike dhe datën. Ato firmosen, sipas rastit, nga pronari

(individual) ose nga përfaqësuesi ligjor i ndërmarrjes ose subjektit tjetër.

Neni 17

Llogaritë vjetore të ndërmarrjeve, shoqërive dhe subjekteve të tjera me përjashtim të atyre që parashikohen në paragrafët e dytë dhe të tretë të nenit 10 të këtij ligji dhe të subjekteve që parashikohen në paragrafin 4 të këtij neni, i nënshtrohen kontrollit dhe vërtetimit ligjor nga ekspertë kontabël të pavarur (jashtë ndërmarrjes).

Për kontrollin dhe vërtetimin ligjor të llogarive vjetore zbatohen dispozitat e ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".

Ndërmarrjet dhe subjektet e tjera, për të cilat nuk ka një detyrim ligjor, mund t'ua besojnë kontrollin e llogarive vjetore të tyre ekspertëve kontabël të pavarur, mbi baza kontraktuese.

Llogaritë vjetore të institucioneve e të organizatave buxhetore dhe të subjekteve të tjera që i nënshtrohen rregullimeve të kontabilitetit publik, kontrollohen sipas parashikimeve në këto rregullime.

Neni 18

Ndërmarrjet dhe subjektet e tjera, me përjashtim të atyre që u nënshtrohen dispozitave të kontabilitetit publik, depozitojnë llogaritë vjetore në organet e statistikës kombëtare të juridiksionit ku kanë selinë, sipas afateve që vijnë:

a) para datës 31 maj të vitit pasardhës për shoqëritë tregtare, llogaritë vjetore të të cilave miratohen nga asamblëtë e përgjithshme;

b) para datës 30 prill të vitit pasardhës për ndërmarrjet dhe subjektet e tjera që përgatitin llogari të konsoliduara, ose zotërojnë pjesëmarrje në shoqëri të tjera;

c) para datës 31 mars të vitit pasardhës për ndërmarrjet dhe subjektet e tjera.

Llogarive vjetore të subjekteve, të parashikuara në shkronjat "b" dhe "c" të këtij neni, u bashkëlidhet vendimi për caktimin të rezultatit të ushtrimit, kurse vendimi depozitohet veçmas, jo më vonë se 30 ditë nga data e mbledhjes së asamblesë të shoqërisë për miratimin e llogarive vjetore.

Llogaritë vjetore depozitohen në dy ekzemplarë dhe përmbajnë gjithashtu pjesën verifikuese të ekspertit kontabël të pavarur, që ka kryer kontrollin ligjor të tyre.

Depozitimi i llogarive vjetore të subjekteve që u nënshtrohen rregullimeve të kontabilitetit publik, bëhet në mënyrën dhe afatet e parashikuara në këto rregullime.

RAPORTI VJETOR

Neni 19

Raporti vjetor përgatitet në formën dhe me përmbajtjen e caktuar në nenin 211 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".

Informatat e shifruara, të paraqitura në raportin vjetor, duhet të jenë në përputhje me ato të paraqitura në llogaritë vjetore.

Raporti vjetor mund të mos depozitohet në organet e statistikës kombëtare, por ndërmarrja duhet ta vërë atë në dispozicion të administratave dhe institucioneve shtetërore që mund të bëjnë edhe kopje të plota ose të pjesshme të këtij raporti.

PUBLIKIMI

Neni 20

Shoqëritë anonime, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe subjektet e tjera ekonomike që shpërndajnë letra me vlerë, publikojnë llogaritë vjetore, bashkë me pjesën verifikuese të ekspertit kontabël që kryen kontrollin ligjor të këtyre llogarive, jo më vonë se 30 ditë nga miratimi i tyre prej organit vendimor të ndërmarrjes. Publikimi i aneksit të llogarive vjetore nuk është i detyruar.

Detyrimi për publikimin e llogarive vjetore sipas parashikimit në nenin 1 të këtij ligji duhet të shtrihet, duke filluar nga ushtrimi që mbyllet më 31 dhjetor 1995, edhe për

subjektet ekonomike të tjera, të cilat do të përcaktohen në sistemin kontabël të përgjithshëm në varësi nga madhësia dhe interesi shoqëror.

Ndërmarrjet, shoqëritë dhe subjektet e tjera ekonomike duhet t'u sigurojnë punëtorëve dhe anëtarëve të tyre mundësinë e marrjes së informacionit të paraqitur në llogaritë vjetore.

RUAJTJA E DOKUMENTEVE KONTABËL

Neni 21

Ndërmarrjet dhe subjektet e tjera mbi të cilat vepron ky ligj, të sigurojnë ruajtjen, në mënyrë të rregullt dhe sipas një sistemi arkivi të caktuar, të inventarit të çeljes së veprimtarisë dhe të inventarëve të tjerë periodikë, të llogarive vjetore dhe të raportit vjetor të veprimtarisë, të librave ose regjistrave kontabël, të dokumenteve që kanë mbështetur këto regjistrime, si dhe të bartësve të tjerë të informatave kontabël.

Ata ruajnë, gjithashtu, çdo dokument që ka të bëjë me procedurat e përpunimit, të kontrollit dhe të interpretimit të regjistrimeve në kontabilitet.

Dokumentet kontabël të sipërpërmendura ruhen në formën e tyre origjinale dhe të lexueshme për të gjithë periudhën e ruajtjes.

Veç rasteve të parashikuara ndryshe nga dispozitat ligjore të tjera, dokumentet kontabël ruhen për 10 vjet rresht nga mbyllja e vitit kalendarik të cilit i përkasin.

KREU III

STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E LLOGARIVE VJETORE

Neni 22

Struktura dhe përmbajtja e llogarive vjetore që tregohen në nenet 23 deri 47 të këtij ligji, përbëjnë regjimin bazë të paraqitjes nga ndërmarrjet, shoqëritë dhe njësitë e tjera që kanë për objekt kryesor veprimtari prodhimi ose shërbimi me qëllime fitimprurëse, kur këto mbajnë kontabilitetin e tyre sipas parimit të të drejtave të konstatuara.

Struktura dhe përmbajtja e llogarive vjetore të subjekteve të tjera, mbi të cilat vepron ky ligj, përcaktohen nga Këshilli i Ministrave ose nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, sipas kompetencave të parashikuara në nenet 3 dhe 4 të këtij ligji.

BILANCI

Neni 23

Bilanci përgatitet dhe paraqitet në formën e llogarisë. Ai përshkruan veç e veç elementet e aktiveve dhe të pasiveve të pasurisë që janë në gjendje në mbyllje të ushtrimeve kontabël, dhe ve në dukje në mënyrë të dalluar shumën e kapitaleve të veta.

Nëse një element i aktiveve ose i pasiveve ka të bëjë me dy a më shumë poste të bilancit dhe është treguar vetëm në njërin prej tyre, duhet të tregohet lidhja e tij me postet e tjera qoftë në bilanc, qoftë në aneksin e llogarive vjetore.

Neni 24

Në aktiv të bilancit paraqiten, të ndara në grupe, rubrika e poste të veçanta, aktivet e qëndrueshme, aktivet qarkulluese dhe aktivet e tjera (llogaritë rregulluese).

Përfshirja e elementëve të pasurisë në aktivet e qëndrueshme ose në aktivet qarkulluese përcaktohet nga destinacioni a qëllimi i përdorimit të këtyre elementeve.

Aktivitet e qëndrueshme përfshijnë elemente të pasurisë që destinohen t'i shërbejnë veprimtarisë së ndërmarrjes për një kohë të gjatë, si rregull, mbi një vit. Në bilanc ato grupohen në aktive të qëndrueshme të patrupëzuara dhe aktive të qëndrueshme financiare.

Aktivitet qarkulluese përfshijnë gjendjet e inventarit, kërkesat për t'u arkëtuar, letrat me vlerë të vendosjes, instrumentet e pagesave dhe mjetet monetare në dorë (arkë) e në llogari.

Neni 25

Ndër aktivet e qëndrueshme të trupëzuara tregohen si poste më vete në bilanc, të paktën, elementet që vijojnë:

- tokat (terrenet)
- ndërtimet;
- instalimet teknike, makineritë e pajisjet dhe instrumentet e veglat e punës;
- mjetet e transportit;
- aktivet e qëndrueshme në proces;
- parapagimet dhe pagesa vjetore për aktive të qëndrueshme të trupëzuara.

Veglat e punës dhe instrumentet që i shërbejnë veprimtarisë së ndërmarrjes si mjete punë për një kohë më pak se një vit, ose që kanë një vlerë të vogël për njësi, mund të mos përfshihen në aktivet e qëndrueshme të trupëzuara, por në aktivet qarkulluese ose drejtpërdrejt në shpenzimet, sipas përcaktimeve në sistemin kontabël të përgjithshëm.

Neni 26

Ndër aktivet e qëndrueshme të patrupëzuara tregohen si poste më vete në bilanc të paktën, këto elemente:

- shpenzimet e nisjes dhe të zgjerimit;
- shpenzimet për kërkimet e aplikuara dhe zhvillimet;
- koncensionet, patentat, licensat, markat, procedurat dhe vlera e të drejta të ngjashme;
- fondi tregtar;
- parapagime dhe pagesa pjesore.

Në postin "shpenzime të nisjes dhe të zgjerimit" përfshihen vetëm shpenzimet e kryera për operacione që kushtëzojnë qenien dhe zhvillimin e ndërmarrjes, me kusht që shuma e tyre të mos u referohet prodhimit të sendeve ose shërbimeve të caktuara.

Në postin "shpenzime të kërkimeve të aplikuara dhe të zhvillimeve" përfshihen vetëm shpenzimet që kanë të bëjnë me përpjekjet e ndërmarrjes në këtë fushë për llogari të saj dhe jo për porosi të marra nga të tretët. Këto shpenzime mund të kapitalizohen në aktiv vetëm me kusht që t'u përgjigjen projekteve qartësisht të individualizuara dhe të kenë, në mbyllje të ushtrimit, shanse serioze për arritje teknike dhe rentabilitet tregtar.

Shpenzimet e zbulimit të mineraleve, të ngjashme me shpenzimet e kërkimeve të aplikuara dhe të zhvillimeve, regjistrohen në këtë post të bilancit.

Në postin "fond tregtar" regjistrohen elementet e patrupëzuara të fondeve të tregtisë të blera nga ndërmarrja, me kusht që të mos jenë të regjistruara në një post tjetër të bilancit.

Neni 27

Ndër aktivet e qëndrueshme financiare në bilanc paraqiten si poste të veçanta, të paktën, elementet që vijojnë:

- pjesëmarrjet;
- kërkesa për arkëtim të lidhura me pjesëmarrjet;
- tituj të tjerë të aktiveve të qëndrueshme financiare;
- kredidhënia;

Në kuptim të këtij ligji, quhen pjesëmarrje të drejta në kapitalin e ndërmarrjeve të tjera, të materializuara me tituj ose jo, të cilat, duke krijuar një lidhje të qëndrueshme (afatgjatë) me këto të fundit, kanë për qëllim të kontribuojnë në veprimtarinë e ndërmarrjes që zotëron pjesëmarrjen.

Nëse ndërmarrja ushtron një kontroll ekskluziv mbi një ose disa ndërmarrje të tjera pjesët e zotëruara në kapitalin e këtyre të fundit dhe kërkesat për arkëtim që rrjedhin prej këtej, paraqiten veçmas në bilanc në postet "pjesët në ndërmarrjet e lidhura" dhe "kërkesa për arkëtim mbi ndërmarrjet e lidhura".

Neni 28

Aktivitet qarkulluese paraqiten në bilanc, duke vënë në dukje veçmas, të paktën, këto elemente:

- Ndër gjendjet e inventarit: materiale kryesore dhe furnizime të tjera, prodhime në proces, produkte të ndërmjetme e të gatshme, mallra, si dhe parapagimet ose pagimet pjesore për porosi furnizimesh.

- Ndër kërkesat për arkëtim: kërkesat që rrjedhin nga shitjet dhe kryerjet e shërbimeve.

- Ndër letrat me vlerë: aksionet, obligacionet dhe letrat e tjera me vlerë, të blera nga ndërmarrja me qëllim të nxjerrjes së fitimeve në një kohë të shkurtër, aksionet dhe pjesët e emetuara nga vetë ndërmarrja dhe të riblera prej saj, nëse një veprim i tillë është i autorizuar nga dispozita të tjera ligjore.

Në përbërje të kërkesave për arkëtim përfshihen edhe të ardhurat që i përkasin ushtrimit, për të cilin është përgatitur bilanci, por që kërkitimi (faturimi) i tyre do të bëhet pas mbylljes së atij ushtrimit. Nëse shumat e këtyre të ardhurave është e një rëndësie të ndjeshme, ato shpjegohen në aneks.

Shumat e kërkesave për arkëtim, afati i mbetur i të cilave është më shumë se një vit, paraqitet veçmas për çdo post të tyre në bilanc.

Neni 29

Në grupin "aktive të tjera" të aktivitet të bilancit paraqiten në poste të veçanta të paktën elementet që tregohen në katër paragrafet e mëposhtëm:

Shpenzimet e regjistruara gjatë ushtrimit kontabël, për të cilin përgatitet bilanci, por që i përkasin një ushtrimi të ardhshëm. Këto shpenzime tregohen në postin "shpenzime të ushtrimeve të ardhshme" dhe nëse janë të një rëndësie të ndjeshme, shpjegohen në aneks.

Shpenzimet e kapitalizuara në aktiv të bilancit, me synim shpërndarjen e tyre në disa ushtrime. Llojet e shpenzimeve për t'u shpërndarë dhe mënyrat e amortizimit të tyre përcaktohen në sistemet kontabël. Nëse këto shpenzime janë të ndjeshme, shpjegohen në aneks duke treguar edhe afatin e amortizimit të tyre.

Diferencat negative që dalin nga konvertimi në lekë shqiptarë i gjendjeve të shprehura në monedha të huaja, të cilat nuk mund të përfshihen në rezultatin e ushtrimit.

Diferencat negative ndërmjet shumës së marrë të një detyrimi dhe shumës për t'u paguar, nëse këto nuk mund të përfshihen në rezultatin e ushtrimit.

Neni 30

Në pasiv të bilancit paraqiten në mënyrë të njëpasnjëshme kapitalet e veta, shumat e parashikuara për rreziqe e shpenzime, detyrimet për t'u paguar dhe pasivet e tjera (llogari rregulluese).

Nëse dispozita të tjera parashikojnë mënyra financimi që sjellin lindjen e elementeve pasive të ndërmjetme midis detyrimeve dhe kapitaleve të veta në pasiv të bilancit të emëruar "fonde të tjera".

Neni 31

Ndër kapitalet e veta paraqiten si poste të veçanta në bilanc të paktën këto elemente:

- kapitali;
- shmangie të rivlerësimit;
- rezervat;
- rezultati i ushtrimit;
- subvencione për investime.

Nëse organi kompetent i ndërmarrjes vendos që të shtyhet caktimi i rezultatit ose i një pjese të rezultatit të ushtrimit, duke ia lënë këtë një vendimi të asamblesë së përgjithshme që do të miratojë llogaritë vjetore të ushtrimit pasardhës, shumat e pacaktuara paraqiten midis kapitaleve të veta, në një post të veçantë "Fitime dhe humbje të bartura".

Neni 32

Shoqëritë që në pajtim me dispozitat e ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" procedojnë në kërkimin e shkallëzuar të kapitalit të nënshkruar, paraqesin në postin e pasivit "kapitali i nënshkruar" shumën gjithsej të këtij kapitali. Shuma e kapitalit të nënshkruar, por të pakërkuar, paraqitet në aktiv të bilancit në krye të grupeve të tjera të tij, në postin "kapital i nënshkruar i pakërkuar".

Nëse në mbyllje të ushtrimit, për të cilin përgatitet bilanci, kundrejt shumës së kapitalit të nënshkruar të kërkuar rezultojnë shuma të paderdhura nga ortakët ose aksionarët ato paraqiten në aktiv të bilancit, midis kërkesave për t'u arkëtuar në postin e veçantë "kapital i nënshkruar", i kërkuar, i paderdhur".

Neni 33

Primet e emisionit përfaqësojnë tepricën e çmimit të shitjes mbi vlerën nominale të aksioneve ose të pjesëve në kapitalin themeltar të shoqërisë. Nëse dispozita ligjore të tjera parashikojnë prime të tjera, këto paraqiten gjithashtu në këtë post të kapitaleve të veta që emërohet "prime të lidhura me kapitalin".

Primet e emisionit mund të përdoren për të përballuar shpenzimet për zmadhimin e kapitalit.

Primet e emisionit, eventualisht edhe primet e tjera, mund të përfshihen tërësisht ose pjesërisht në kapital, në kushtet dhe me respektimin e dispozitave të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" lidhur me zmadhimin e kapitalit. Këto prime mundet gjithashtu të përfshihen në një rezervë tjetër të qëndrueshme, sipas vendimit të organit kompetent të ndërmarrjes.

Nuk lejohet që primet të vihen në shpërndarje, të mbulojnë humbje ose të përdoren për të krijuar shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime.

Neni 34

Në postin "shmangie të rivlerësimit" paraqiten plus vlerat e rezultuara nga rivlerësimet e elementëve të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe të atyre financiare.

Kushtet dhe rregullat e kryerjes të rivlerësimit përcaktohen me vendime të Këshillit të Ministrave. Rivlerësimi duhet të kryhet në çdo çast për tërësinë e elementëve.

Asnjë pjesë e plus vlerave nga rivlerësimi nuk mund të vihet në shpërndarje, direkte ose indirekte, duke përjashtuar rastet kur u përgjigjet elementeve të realizuara (shitura). Ato nuk mund të përdoren për të kompensuar humbjet nga veprimtaria.

Shmangiet e rivlerësimit mund të përfshihen tërësisht ose pjesërisht në kapital, sipas kushteve dhe mënyrës se parashikuar në vendimet e Këshillit të Ministrave dhe në çdo rast me miratimin e organit kompetent të ndërmarrjes.

Neni 35

Në postin e kapitaleve të veta "rezerva" paraqiten fitimet e caktuara për t'u lënë për një kohë të gjatë në ndërmarrje, në zbatim të dispozitave ligjore, të dispozitave statutores ose të vendimeve të organeve kompetente të ndërmarrjes. Këto rezerva mund të kenë për origjinë edhe xhirimin e një elementi tjetër të kapitaleve të veta, përveç kapitalit themeltar.

Ndër rezervat paraqiten veçmas në bilanc rezerva ligjore, rezerva statutores ose kontraktuese dhe rezerva të tjera.

Përdorimi i rezervave bëhet sipas kushteve të parashikuara në dispozitat ligjore dhe statutores përkatëse, në bazë të vendimeve të organit kompetent të ndërmarrjes.

Neni 36

Në postin e bilancit "rezultati i ushtrimit" paraqitet shuma e fitimeve të realizuara ose e humbjeve të pësura nga veprimtaria e ndërmarrjes gjatë ushtrimit të dhënë.

Shuma e fitimeve ose e humbjeve paraqiten në bilanc për gjendjen e tyre para shpërndarjes, të

pakësuara për shumën e tatimit mbi fitimin dhe të ndonjë derdhjeje tjetër të ngjashme.

Shuma e fitimeve ose e humbjeve të paraqitura në bilanc duhet të jetë e njëjtë me shumën e tyre neto të treguar në llogarinë e fitimeve dhe të humbjeve.

Neni 37

Në postin "subvencione për investime" paraqiten shumat që ndërmarrja përfiton nga shteti, nga një ent shtetëror ose privat me qëllim që të blejë ose të krijojë aktive të qëndrueshme ose të financojë veprimtari afatgjatë.

Subvencionet për investime shpërndahen dhe përfshihen në rezultatet e ushtrimeve të ndryshme në masën dhe mënyrat e parashikuara në sistemin kontabël të përgjithshëm.

Subvencionet për investime nuk merren parasysh në përcaktimin e "gjendjes neto" të ndërmarrjes.

Neni 38

Shumat e parashikuara për rreziqe e shpenzime kanë për objekt të mbulojnë humbje ose shpenzime, të cilat janë qartësisht të përcaktuara përsa i përket natyrës, por që në datën e mbylljes së bilancit janë të papërcaktuara përsa i përket shumës dhe datës së vërtetimit.

Shumat e parashikuara për rreziqe e shpenzime duhet të rezultojnë nga një vlerësim i arsyeshëm i fakteve në mbyllje të ushtrimit. Nëse elementet e vlerësimit janë kontradiktore ose të pamjaftueshme, nuk duhet proceduar në krijimin e tyre, por ngjarjet dhe ndikimet e tyre shpjegohen në aneksin e llogarive vjetore.

Shumat e parashikuara për rreziqe e shpenzime krijohen pavarësisht nëse ushtrimi mbyllet me fitim apo me humbje. Krijimi i shumave të fshehura është i ndaluar.

Shumat e parashikuara për rreziqe e shpenzime nuk korrigjojnë vlerat e elementeve të aktiveve për të cilat janë krijuar, por tregohen veçmas në pasiv të bilancit.

Neni 39

Ndër detyrimet për t'u paguar paraqiten si poste më vete të pasivit të bilancit të paktën këto elemente:

- huatë e marra nga bankat dhe institutet e tjera të kreditit;
- huatë dhe detyrimet e tjera financiare;
- detyrimet tatimore e shoqërore;
- detyrimet për blerje e shërbime të kryera nga të tretët;
- detyrimet për paradhënie ose pagesa të pjesshme të marra me porosi.

Nëse në pajtim me dispozita ligjore të tjera ndërmarrja emeton obligacione ose të tjera letra me vlerë me qëllime huamarrjeje, shuma e këtyre huave paraqitet si post i veçantë i detyrimeve për t'u paguar.

Ndër detyrimet për t'u paguar paraqiten edhe shpenzimet që i përkasin ushtrimit, për të cilin përgatitet bilanci, por që kërkimi (faturimi) i tyre nga të tretët do të bëhet në një ushtrim të ardhshëm.

Shuma e detyrimeve me afat pagimi më pak se një vit nga data e mbylljes të ushtrimit tregohen veçmas për çdo post të tyre në bilanc.

Neni 40

Të ardhurat e regjistruara gjatë ushtrimit për të cilin përgatitet bilanci, por që i përkasin një ushtrimi të ardhshëm, paraqiten veçmas në pasiv të bilancit, si një post rregullues, me emërtimin "të ardhura të ushtrimeve të ardhshme". Nëse këto të ardhura janë të një rëndësie të ndjeshme shpjegohen në aneks.

Nëse nga konvertimi në lekë shqiptarë i veprimeve dhe gjendjeve të shprehura në monedha të huaja rezultojnë plus vlera që nuk mund të përfshihen në rezultatin e ushtrimit, këto paraqiten si post i veçantë i pasivit të bilancit me emërtimin "diferenca konvertimi pasive".

Neni 41

Ndërmarrjet mund të paraqitin në bilancet e tyre të dhëna më të hollësishme nga ato të parashikuara në nenet 25 deri në 40 të këtij ligji, por me kusht që të respektohet struktura dhe terminologjia e përcaktuar.

Ndërmarrjet mund të paraqitin një bilanc më të shkurtuar nga ai i paraqitur në nenet 25 deri në 40, nëse kanë një numër mesatar vjetor gjer në 50 punëtorë dhe kur nuk tejkalojnë kufirin e caktuar në sistemin kontabël të përgjithshëm për shumën e të ardhurave vjetore ose për totalin e aktivitetit të bilancit në mbyllje të ushtrimit. Kjo e drejtë humbet nëse ndërmarrja tejkalon njërin prej dy treguesve të vendosur gjatë dy vjetëve të njëpasnjëshëm.

LLOGARIA E FITIMEVE DHE E HUMBJEVE

Neni 42

Llogaria e fitimeve dhe e humbjeve paraqitet në formë llogarie dhe vë në dukje, nga njëra anë, të ardhurat e realizuara që i përkasin ushtrimit, dhe nga ana tjetër, shpenzimet për arritjen e këtyre të ardhurave.

Në llogarinë e fitimeve e të humbjeve të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten të klasifikuara sipas natyrës së tyre në postet e parashikuara në nenet 43 deri 46 të këtij ligji, duke mundësuar edhe grupimin e tyre në:

- të ardhura dhe shpenzime të veprimtarisë së zakonshme (të shfrytëzimit dhe financiare);
- të ardhura dhe shpenzime nga veprime ose ngjarje të jashtëzakonshme.

Në llogarinë e fitimeve dhe humbjeve rezultati i ushtrimit paraqitet në dy nivele:

- rezultati para tatimit mbi fitimin;
- rezultati pas zbritjes së tatimit mbi fitimin dhe ndonjë zbritje tjetër të ngjashme.

Tatimi mbi fitimet paraqitet si post i veçantë.

Neni 43

Në llogarinë e fitimeve dhe të humbjeve të ardhurat nga veprimtaritë e zakonshme paraqiten sipas kërkesave të këtyre rubrikave dhe posteve:

A. Të ardhurat e shfrytëzimit:

1. Shitjet me tregtimin veças, nëse është rasti, të shitjes së mallrave, të shitjes së produkteve dhe të dorëzimit të shërbimeve si dhe të shitjes jashtë vendit.

2. Shtesa e gjendjes së produkteve dhe të prodhimit në proces.

3. Produktet e krijuara ose punimet e kryera nga ndërmarrja për nevojat e saj, të kaluara në aktivet e qëndrueshme.

4. Subvencionet e shfrytëzimit.

5. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit.

B. Të ardhurat financiare:

6. Të ardhurat nga pjesëmarrjet.

7. Të ardhura nga aktivet e tjera të qëndrueshme financiare.

8. Të tjera interesa dhe të ardhura të ngjashme.

9. Të ardhurat neto nga shitja e letrave me vlerë të vendosjes.

10. Diferencat pozitive të këmbimeve valutore.

Nëse gjatë ushtrimit është proceduar në rimarrjen e shumave të parashikuara, këto paraqiten si post më vete i të ardhurave të shfrytëzimit ose i të ardhurave financiare.

Të ardhurat financiare nga ndërmarrjet e lidhura paraqiten veças në llogarinë e fitimeve dhe të humbjeve, brenda posteve të mësipërme 6,7 dhe 8.

Neni 44

Në llogarinë e fitimeve dhe të humbjeve shpenzimet për veprimtaritë e zakonshme paraqiten sipas rubrikave dhe posteve që vijnë:

- A. Shpenzime të shfrytëzimit:
1. Pakësimi i gjendjes së produkteve dhe të prodhimit në proces.
 2. Blerjet me tregtim veças, kur është rasti, të blerjeve të mallrave e të materialeve të tjera.
 3. Shërbime të kryera nga të tretët.
 4. Shpenzime të personelit:
 - paga dhe trajtime;
 - shpenzime shoqërore.
 5. Shuma të amortizimeve, suma të parashikuara për zhvlerësime dhe suma të parashikuara për rreziqe e shpenzime:
 - amortizime të aktiveve të qëndrueshme;
 - suma të parashikuara për zhvlerësime të aktiveve të qarkulluese;
 - suma të parashikuara për rreziqe e shpenzime.
 6. Tatime, taksa dhe derdhje të ngjashme (me përjashtim të atyre mbi fitimet).
 7. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit.
- B. Shpenzime financiare:
8. Shuma të parashikuara për zhvlerësime të aktiveve financiare të qëndrueshme dhe qarkulluese.
 9. Interesa të paguara dhe shpenzime të ngjashme, me tregtimin veças, kur është rasti të atyre të ndërmarrjeve të lidhura.

Neni 45

Të ardhurat nga shitja, të treguara në pikën A1 të nenit 43 përfaqësojnë shumën neto të shifrës së afarizmit. Këto të ardhura paraqiten me vlerën sipas çmimeve faktike, minus rabatet dhe zbritjet e tjera të ngjashme. Të ardhurat nga shitjet paraqiten të zhveshura nga tatimi i qarkullimit ose nga një tatim tjetër i ngjashëm mbi shitjet.

Blerjet e mallrave dhe të materialeve paraqiten në llogarinë e fitimeve dhe të humbjeve në masën që ato janë shitur ose përdorur gjatë ushtrimit, të zhveshura nga rabatet a zbritjet e tjera të përfituara nga furnitorët.

Neni 46

Të ardhura dhe shpenzime të jashtëzakonshme janë ato që rrjedhin nga veprime ose ngjarje, të cilat nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me veprimtarinë e zakonshme të ndërmarrjes, që nuk kanë përsëritje periodike dhe që në përgjithësi janë jashtë mundësive të kontrollit nga ndërmarrja.

Të ardhura ose shpenzime të jashtëzakonshme quhet edhe efektet e gabimeve të mëdha në mbylljen e llogarive vjetore të viteve të mëparshme, të cilat, në respektim të parimeve të paprekshmërisë së bilancit të çeljes, nuk prekin shumën e kapitaleve të vetra.

Nëse të ardhurat dhe shpenzimet e jashtëzakonshme janë të rëndësishme për të vlerësuar rezultatin e ndërmarrjes, suma, natyra dhe shkaqet e tyre tregohen dhe shpjegohen në aneksin e llogarive vjetore.

Neni 47

Ndërmarrjet mund të paraqitin në llogarinë e fitimeve dhe të humbjeve të dhëna më të hollësishme nga ato të parashikuara në nenet 43 dhe 44 të këtij ligji, por duke respektuar strukturën dhe terminologjinë e caktuar.

Ndërmarrjet e parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 41 të këtij ligji mund të paraqitin llogarinë e fitimeve dhe të humbjeve në një formë më të shkurtër nga ajo e treguar më sipër.

Llogaria e fitimeve dhe e humbjeve mund të paraqitet edhe në formën e mbështetur në kostot e shitjeve, por në këtë rast duhet të jepen informata plotësuese për nevojat e statistikës kombëtare.

PËRMBAJTJA E ANEKSIT TE LLOGARIVE VJETORE

Neni 48

Aneksi i llogarive vjetore përmban informata të shifruara dhe tekste shpjeguese që synojnë:

- të vënë në dukje parimet, rregullat dhe metodat e zbatuara për përgatitjen e llogarive vjetore;
- të zbërthejnë poste të ndryshme të bilancit dhe të llogarisë së fitimeve e të humbjeve;
- të plotësojnë llogaritë vjetore me të dhëna të tjera të nevojshme.

Përmbajtja e aneksit përcaktohet në tërësi nga parimi i rëndësisë kuptimore të informatave të tij për përdoruesit e llogarive vjetore të ndërmarrjes.

Përveç informatave të parashikuara në nene të vaçanta, aneksi i llogarive vjetore përmban informatat që tregohen në nenet 49 deri 52 të këtij ligji.

Neni 49

Në aneks përmenden parimet dhe rregullat e përgjithshme, në të cilat është mbështetur përgatitja e llogarive vjetore. Nëse nuk ka pasur shmangie nga këto parime e rregulla, bëhet vetëm një pohim i përgjithshëm. Nëse për arsye të përligjura ka shmangie nga këto parime e rregulla, në aneks tregohet shkaku, arsyetimi përkatës dhe ndikimi i tyre në pasurinë, gjendjen financiare dhe në rezultatet e ndërmarrjes.

Kur dispozitat ligjore parashikojnë më shumë se një metodë për vlerësimin e veprimeve të ndryshme, në aneks tregohet metoda e zbatuar nga ndërmarrja.

Në rastet e ndryshimit, nga një ushtrim në tjetrin, të paraqitjes së llogarive vjetore dhe të metodave të vlerësimit, këto ndryshime përshkruhen dhe arsyetohen në aneksin e llogarive vjetore, duke treguar edhe efektet e tyre në pasurinë, në gjendjen financiare dhe në rezultatet e ndërmarrjes.

Në aneks tregohen edhe metodat e përdorura për llogaritjen e amortizimeve dhe të shumave të parashikuara, bazat e përdorura për konvertimin në lekë shqiptare të elementeve të shprehura në monedha të huaja, si dhe natyra, shuma dhe trajtimi kontabël i shmangieve nga konvertimi.

Për elementet e këmbyeshme të aktiveve qarkulluese tregohet, nëse është rasti, diferenca ndërmjet vlerës që figuron në bilanc dhe vlerës që do të rezultonte nga çmimet e fundit të tregut, të njohura në datën e mbylljes së llogarive.

Neni 50

Ndër informatat që zbërthejnë poste të ndryshme të bilancit dhe të llogarisë së fitimeve dhe humbjeve paraqiten në aneks të paktën:

- Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme.

- Gjendja dhe ndryshimet e amortizimeve.

- Gjendja dhe ndryshimet e shumave të parashikuara për zhvlerësime dhe për rreziqe e shpenzime.

- Gjendja e kërkesave për t'u arkëtuar dhe e detyrimve për t'u paguar sipas afateve të mbetura, duke dalluar veças ato me afat mbi 5 vjet.

- Përbërja e shpenzimeve të nisjes e të zgjerimit, të shpenzimeve të kërkimeve e të zhvillimit të fondit tregtar, duke treguar edhe afatet e zbatuara për amortizimin e tyre, veçanërisht kur ky afat është mbi 5 vjet.

Në rastet e rivlerësimit në aneks paraqiten metodat e zbatuara për llogaritjen e vlerave të mbajtura në bilanc, lista e posteve përkatëse të bilancit e të llogarisë së rezultatit dhe shumat korresponduese, trajtimi tatimor i shmangieve nga rivlerësimi dhe shumat që kanë prekur gjatë ushtrimit postet e pasivit përkatës të bilancit.

Në aneks tregohet edhe shpërndarja e shumës neto të shifrës së afarizmit sipas sektorëve të veprimtarisë dhe tregjeve gjeografike. Nëse disa nga këta tregues nuk deklarohen për shkak të dëmit të madh që mund të rezultojë nga publikimi i tyre, shënohet karakteri jo i plotë i kësaj informate.

Në aneks tregohen, nëse është rasti, ndikimi në rezultatin e ushtrimit dhe në kapitalet e veta i elementeve që rrjedhin nga zbatimi i dispozitave tatimore.

Neni 51

Ndër informatat e tjera plotësuese në aneksin e llogarive vjetore tregohen të paktën të dhënat

që vijojnë:

a) Shumat e angazhimeve financiare në cilësinë e një garancie çfarëdo, kur tregimi i tyre është i nevojshëm për të vlerësuar gjendjen financiare të ndërmarrjeve. Shumat e angazhimeve në fushën e pensioneve dhe ato ndaj ndërmarrjeve të grupit tregohen veças nga të tjera.

b) Numri mesatar i punonjësve dhe i atyre të punësuar gjatë ushtrimit, të ndarë në kategori, si dhe shpenzimet për pagat, për sigurime shoqërore dhe trajtime të punonjësve.

c) Shuma e shpërblimeve të anëtarëve të organeve të administrimit, të drejtimit ose të mbikëqyrjes të ndërmarrjes.

Këto shuma jepen në mënyrë globale për çdo kategori të këtyre organeve.

Neni 52

Ndërmarrjet ose shoqëritë që kapitalin e kanë të ndarë në aksione ose në pjesë, që shpërndajnë letra me vlerë ose që zotërojnë pjesëmarrje në ndërmarrje të tjera tregojnë në aneksin e llogarive vjetore, sips rastit:

a) numrin dhe vlerën e aksioneve dhe të pjesëve që përbëjnë kapitalin themeltar, si dhe të atyre që janë emetuar gjatë ushtrimit të ndara sipas kategorive;

b) titujt e tjerë të emetuar nga ndërmarrja, duke vënë në dukje numrin dhe vlerën e tyre, si dhe të drejtat që ato sigurojnë;

c) emrin, adresën, shumën e kapitalit të vet dhe rezultatin e ushtrimit kontabël të fundit të ndërmarrjeve ku zotërojnë pjesëmarrje.

Ndërmarrjet që shpërndajnë letra me vlerë, të cilat tejkalojnë kufijtë e vendosur në sistemin kontabël të përgjithshëm për shumën e të ardhurave vjetore dhe të kapitalit përgatitin gjithashtu tabelën e financimit.

KREU IV RREGULLAT E PËRGATITJES TË LLOGARITJEVE VJETORE PARIMET E PËRGJITHSHME

Neni 53

Përgatitja e llogarive vjetore dhe mbajtja e kontabilitetit që i mbështet këto llogari, bëhet në përputhje me parimet dhe rregullat e parashikuara në nenet 54 deri 70 të këtij ligji.

Shmangie nga këto parime e rregulla janë të lejueshme për rrethana të veçanta, sipas kushteve të parashikuara në këtë ligj.

Neni 54

Për përgatitjen e llogarive vjetore mbahet parasysh që ndërmarrja do ta vijojë veprimtarinë në një të ardhme të parashikueshme dhe se ndonjë zvogëlim i ndjeshëm i kësaj veprimtarie nuk pritet (parimi i vijueshmërisë).

Metodat e vlerësimit dhe forma e paraqitjes së llogarive vjetore nuk mund të ndryshohen nga një ushtrim kontabël në tjetrin, duke përjashtuar rastet kur kanë ndodhur ndryshime të rëndësishme (parimi i qëndrueshmërisë së metodave).

Për çdo post të bilancit dhe të llogarisë së fitimeve e të humbjeve duhet të paraqitet edhe shifra korresponduese e ushtrimit paraardhës (parimi i krahasueshmërisë).

Bilanci i çeljes së një ushtrimi duhet të korrespondojë me bilancin e mbylljes të ushtrimit paraardhës (Parimi i paprekshmërisë së bilancit të çeljes).

Neni 55

Llogaritë vjetore përgatiten në mënyrë transparente e të kuptueshme dhe u japin përdoruesve të tyre një përshkrim të plotë, të qartë dhe të ndershëm të gjendjes së ndërmarrjes dhe të rezultateve të saj (parimi i sinqeritetit).

Elementet e pasurisë që figurojnë të regjistruara në kontabilitet dhe që tregohen në llogaritë

vjetore, duhet të gjenden në realitet dhe të mund të vërtetohen nga një ekspert jashtë ndërmarrjes (parimi i së vërtetës).

Neni 56

Në përgatitjen e llogarive vjetore bëhet vlerësimi i arsyeshëm i fakteve ekonomike (parimi i kujdesit).

Parimi i kujdesit duhet respektuar në çdo rast dhe veçanërisht:

a) në llogaritë vjetore të përfshihen vetëm fitimet e realizuara që janë të vërtetuara në datën e mbylljes së bilancit;

b) në llogaritë vjetore merren parasysh rreziqet e parashikuara dhe humbjet e mundshme të vërtetuara gjatë ushtrimit ose një ushtrimi të mëparshëm, edhe nëse këto rreziqe apo humbje janë bërë të njohura ndërmjet datës së mbylljes të ushtrimit kontabël dhe datës të përgatitjes së bilancit.

c) zhvlerësimet për shkak të përdorimit ose për shkaqe të tjera përfshihen në rezultat, pavarësisht nëse ushtrimi kontabël mbyllet me humbje a me fitim.

Neni 57

Për qëllime të përgatitjes së llogarive vjetore çdo ushtrim kontabël quhet i pavarur nga ushtrimet kontabël të tjera, në të cilët shtrihet veprimtaria e ndërmarrjes (parimi i pavarësisë së ushtrimit kontabël).

Në përcaktimin e rezultatit të ushtrimit kontabël, për të cilin përgatiten llogaritë vjetore, përfshihen të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet që i përkasin atij ushtrimi, pa marrë parasysh datën e arkëtimit të të ardhurave ose të pagimit të shpenzimeve (parimi i tërheqjes sipas ushtrimeve kontabël).

Neni 58

Elementet e posteve të aktivitetit dhe të pasivitetit vlerësohen veç e veç (parimi i vlerësimit individual).

Një post i aktivitetit të bilancit nuk mund të kompensohet me një post të pasivitetit dhe një post i të ardhurave në llogarinë e fitimeve e të humbjeve nuk mund të kompensohet me një post të shpenzimeve (parimi i moskompensimit).

RREGULLAT E VLERËSIMIT

Neni 59

Në datën e hyrjes në pasurinë e ndërmarrjes aktivitetet e qëndrueshme vlerësohen:

a) me koston e marrjes, nëse janë blerë;

b) me koston e prodhimit, nëse janë krijuar nga vetë ndërmarrja.

Vlera në hyrje e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara mund të korrigjohet në rritje, vetëm në rastet kur atyre u bëhen ndryshime që sjellin rritjen e kohës së shërbimit, të aftësive prodhuese a fitimprurëse, si dhe në rastet kur autorizohet rivlerësimi i tyre.

Neni 60

Kostoja e marrjes përcaktohet duke i shtuar çmimit të blerjes shpenzimet e tjera që lidhen me blerjen, me sjelljen dhe me vënien në gjendje përdorimi për herë të parë, në masën që këto shpenzime janë të përcaktueshme për elementin e dhënë, drejtpërdrejt ose tërthorazi.

Taksat doganore, taksat dhe tatimet e tjera të lidhura drejtpërdrejt me blerjen, të cilat mbeten në ngarkim të ndërmarrjes, përfshihen në koston e marrjes të elementeve të blera.

Neni 61

Kostoja e prodhimit përcaktohet duke i shtuar koston e marrjes së materialeve të harxhuara

për prodhimin kostot e tjera të drejtpërdrejta që përfshihen në aktivin e dhënë.

Kostoja e prodhimit të një aktivi të qëndrueshëm mund të përfshijë një pjesë të arsyeshme të kostove jo të drejtpërdrejta, në masën që këto i përkasin periudhës së prodhimit të këtij aktivi.

Lejohet që në koston e prodhimit të një aktivi të qëndrueshëm, të përfshihen interesat mbi huatë e marra për të financuar prodhimin, në masën që këto interesa i përkasin periudhës së fabrikimit. Në këtë rast shuma e interesave të përfshira në kosto tregohet në aneksin e llogarive vjetore.

Neni 62

Në datën e hyrjes në pasurinë e ndërmarrjes, elementet e aktiveve qarkulluese vlerësohen me koston e marrjes, kur blihen në të tretë, ose me koston e prodhimit kur krijohen nga vetë ndërmarrja.

Përcaktimi i kostos së marrjes dhe i kostos së prodhimit sipas parashikimeve në paragrafin e parë të nenit 60 dhe në paragrafin e parë e të dytë të nenit 61 janë të zbatueshme edhe për këto elemente.

Përfshirja e interesave për huatë e marra në koston e prodhimit të një elementi të aktiveve qarkulluese është e lejueshme vetëm në rastet kur cikli i prodhimit është më shumë se 12 muaj.

Nuk lejohet që në koston e prodhimit të përfshihen shpenzimet e shpërndarjes (të shitjes).

Neni 63

Për vlerësimet në dalje kostoja e marrjes ose kostoja e prodhimit të objekteve të së njëjtës kategori të materialeve a të mallrave të blera, të produkteve të prodhuara, si dhe të elementeve të tjera qarkulluese, mund të llogariten në bazë të metodës së mesatares të ponderuar, të metodës "hyrje-dalje e parë" (FIFO), ose të një metode tjetër të parashikuar në sistemin kontabël.

Neni 64

Për aktivet e qëndrueshme të trupëzuara, potenciali i shërbimit të të cilave zvogëlohet normalisht nga përdorimi, nga ndryshimet teknike dhe nga shkaqe të tjera të parashikueshme, duhet të përcaktohet nga zhvlerësimi i tyre. Ky zhvlerësim përcaktohet sipas një plani amortizimesh, duke e shpërndarë koston e marrjes ose koston e prodhimit të këtyre aktiveve në të gjitha ushtrimet e parashikuara për të vazhduar shërbimi i tyre.

Amortizimet për zhvlerësimin llogariten sipas kritereve të përcaktuara nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë.

Nuk llogariten amortizime për zhvlerësime për tokat (duke përjashtuar terrenet e shfrytëzimit), për pyjet, për objektet e artit, për aktivet e qëndrueshme në proces dhe për ato të amortizuara plotësisht.

Neni 65

Aktivitet e qëndrueshme të patrupëzuara duhet të amortizohen (shlyhen) brenda një kohe të arsyeshme, e shumta deri në 5 vjet nga data e hyrjes në pasurinë e ndërmarrjes.

Nëse për elemente të veçanta të këtyre aktiveve është i përligjur një afat amortizimi mbi 5 vjet, këto raste parashikohen në sistemin kontabël të përgjithshëm dhe, në mungesë të një parashikimi, duhet të miratohen nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë.

Sa kohë që shpenzimet për nisjen dhe për zgjerimin e veprimtarisë dhe shpenzimet për kërkime të zbatueshme e zhvillime nuk janë amortizuar tërësisht, ndërmarrja nuk mund të procedojë në shpërndarje të rezultateve, në qoftë se shuma e rezervave të lira për këtë qëllim nuk është të paktën e barabartë me shumën e shpenzimeve të paamortizuara.

Neni 66

Në llogaritë vjetore vlerësimi i elementeve të aktiveve bëhet sipas kostos së marrjes a kostos së prodhimit, ose të një vlere tjetër të regjistruar në kontabilitet.

Vlerësimi i elementeve të aktivitet në llogaritë vjetore me një vlerë më të lartë se kostoja e

marrjes a kostoja e prodhimit nuk është i lejuar, përveç rasteve të veçanta të parashikuara në nenin 70 të këtij ligji.

Kostoja e marrjes ose kostoja e prodhimit të elementeve të aktiveve të qëndrueshme pakësohet me shumën e amortizimeve të akumuluar deri në datën e mbylljes së bilancit.

Neni 67

Vlera e aktiveve të qëndrueshme financiare mund të bëhet objekt korrigjime për t'u dhënë këtyre elementeve një vlerë më të ulët, që rezulton nga kushtet e tregut në datën e mbylljes së bilancit ose nga zhvillimi i pafavorshëm i faktorëve ekonomikë, me kusht që rënia e kurseve të bursës ose zhvillimi i faktorëve të tjerë të mos rrjedhë nga rrethana të përkohshme apo aksidentale.

Vlera e aktiveve të qëndrueshme duhet të bëhet objekt korrigjimi, me qëllim që t'u jepet një vlerë më e ulët që rezulton në datën e mbylljes së bilancit (vlerë aktuale), me kusht që rënia e vlerës të ketë vazhduar për një kohë të gjatë dhe të gjykohet se do të vijë edhe më tej.

Korrigjimet e vlerave, të parashikuara në paragrafët e parë e të dytë të këtij neni, kalojnë në llogarinë e fitimeve e të humbjeve dhe tregohen veçmas në aneksin e llogaritjeve vjetore, në rast se nuk janë paraqitur veçmas në llogarinë e fitimeve dhe të humbjeve.

Vlerësimi me vlerë më të ulët, i parashikuar në paragrafët e parë e të dytë të këtij neni, nuk mund të ruhet në kontabilitet, kur kanë pushuar së qeni arsyet që kanë diktuar korrigjimet.

Neni 68

Elementet e aktiveve qarkulluese bëhen objekt e pakësimit të vlerës, me qëllim që t'u jepet këtyre elementeve vlera e tregut (vlera aktuale) në mbyllje të ushtrimit ose, në raste përjashtimore, një vlerë tjetër më e ulët që u duhet dhënë atyre në datën e mbylljes së bilancit.

Kushtet e caktuara në paragrafët e tretë dhe të katërt të nenit 67 janë të zbatueshme edhe për korrigjimet e vlerës të elementeve të aktiveve qarkulluese.

Neni 69

Kapitalet e veta, detyrimet ndaj të tretëve dhe elementet e tjera të pasivit paraqiten në bilancin vjetor me vlerën që figuron në kontabilitet (vlera e regjistruar).

Në se shuma për t'u paguar e detyrimeve është më e lartë se shuma e marrë, në bilanc paraqitet shuma e për t'u paguar.

Diferenca tregohet në aktiv të bilancit dhe duhet të amortizohet me shuma vjetore të arsyeshme brenda afatit të shlyerjes së detyrimit.

Neni 70

Rregulla dhe procedura vlerësimi, të ndryshme nga ato të parashikuara në nenet 59 deri 69, mund të zbatohen:

- a) kur hyrja e elemnteve të aktivit nuk rrjedh nga një blerje ose nga prodhimi i vetë ndërmarrjes;
- b) kur ndërmarrja përgatit llogari vjetore të konsoliduara;
- c) kur Këshilli i Ministrave autorizon rivlerësimin e elementeve të pasurisë, me qëllim që të merren parasysh proceset inflacioniste;
- ç) kur ndërmarrja transferohet, ndahet, bashkohet, likuidohet ose vihet në shitje;
- d) kur me zbatimin e rregullave të përgjithshme të vlerësimit, nuk sigurohet, për raste të veçanta, një pamje besnike e pasurisë, e gjendjes financiare dhe e rezultatit të ndërmarrjes.

Rregullat e veçanta të vlerësimit parashikohen në dispozitat rregulluese që nxirren në zbatim të këtij ligji dhe në mungesë të një parashikimi, me miratim të Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë.

KREU V
PËRGJEGJËSIA PËR ZBATIMIN E LIGJIT
SHKELJET DHE PASOJAT

Neni 71

Me rezervën e parashikimeve të ndryshme nga dispozita ligjore të tjera, përgjegjësia për zbatimin e këtij ligji bie mbi përfaqësuesin ose përfaqësuesit ligjore të ndërmarrjes, shoqërisë a subjektit tjetër.

Nëse mbajtja e kontabilitetit dhe përgatitja e informacionit kontabël - financiar u është besuar të tretëve, personave juridikë ose fizikë, këta bëhen përgjegjës për shkeljet e dispozitave të këtij ligji njëjloj si përfaqësuse ligjor i subjektit.

Neni 72

Shkeljet dispozitave të këtij ligji, nëse nuk përbëjnë vepra penale, dënohen me gjobë personale nga 3000 deri në 5000 lekë për çdo rast.

Të drejtën e dënimit sipas këtij ligji e kanë inspektorët e kontabilitetit të Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, punonjësit e organeve financiare dhe të kontroll-revizionit të ministrive e institucioneve të tjera qendrore dhe punonjësit e kontroll-revizionit të organeve të pushtetit lokal.

Organet e tjera të kontrollit shtetëror që janë të autorizuar të ndërhyjnë në kontabilitet dhe në informacionin kontabël financiar për shkeljet e gjetura zbatojnë dënimet e parashikuara në ligjet përkatëse.

Ankimi ndaj vendimit të gjobitjes mund të bëhet, brenda 10 ditëve nga data e komunikimit të tij, sipas rastit, te drejtorët e drejtorive përkatëse të ministrive e institucioneve të tjera qendrore, si dhe te drejtuesi i organit përkatës të kontrollit të pushtetit lokal, vendimi i të cilëve është i formës së prerë.

KREU VI
DISPOZITA TË FUNDIT DHE TË PËRKOHSHME
KESHILLI KOMBËTAR I KONTABILITETIT

Neni 73

Për të realizuar normalizimin e kontabilitetit sipas dispozitave të këtij ligji, si dhe për të siguruar një udhëheqje metodologjike të vijueshme të tij, krijohet Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, i përbërë nga jo më shumë se 9 anëtarë, punonjës të shkencës e të arsimit dhe specialistë të dikastereve qendrore e të ndërmarrjeve. Ky këshill drejtohet nga një kryetar i zgjedhur me votim të lirë nga anëtarët e tij.

Në veprimtarinë e tij Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit ndihmohet nga një sekretariat i përbërë nga tre punonjës, të cilët emërohen nga ministri i Financave dhe i Ekonomisë.

Neni 74

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit ka këto funksione dhe detyra kryesore:

- a) i rekomandon ministrit të Financave dhe të Ekonomisë amendamentet e nevojshme të këtij ligji;
- b) rishikon normat kontabël ekzistuese dhe krijon norma të reja, të cilat ia paraqet për miratim Këshillit të Ministrave;
- c) ndjek zbatimin praktik të sistemit të kontabilitetit dhe jep rekomandime për zgjidhjen e problemeve që lindin në këtë fushë;
- ç) jep mendim për pajtueshmërinë ligjore metodologjike për sistemet dhe regjimet kontabël që vendosen në zbatim të këtij ligji;
- d) jep mendime dhe rekomandime për përgatitjen e specialistëve kontabël në shkollat e larta dhe të mesme të vendit;
- dh) mban lidhje me institucione e organizma shkencore e profesionale të vendeve të tjera

ndërkombëtare dhe realizon pjesëmarrjen në veprimtaritë e organizuara prej tyre për probleme të kontabilitetit.

Neni 75

Përgatitja, paraqitja ose publikimi i llogarive vjetore sipas strukturës dhe përmbajtjes të parashikuar në Kreun III të këtij ligji duhet të fillojë:

a) jo më vonë se ushtrimi që nis në 1 janar 1994 për ndërmarrjet, shoqëritë dhe subjekte të tjera që ushtrojnë veprimtari prodhimi, tregtie apo shërbimi;

b) jo më vonë se ushtrimi që nis më 1 janar 1995 për të gjitha subjektet e tjera mbi të cilat vepron ky ligj.

Llogaritë vjetore të konsoliduara do të përgatiten, paraqiten dhe publikohen duke filluar nga ushtrimi që nis në datën 1 janar 1995.

Afatet e caktura në këtë nen nuk sjellin moszbatimin e dispozitave të tjera të ligjit dhe as moszbatimin e sanksioneve për leje të tyre, sipas paragrafit të parë të nenit 72.

Neni 76

Ligji nr.7425, datë 14.11.1990 "Për kontabilitetin", si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 77

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.449, datë 2.2.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha